



International Observation Mission to Kosovo Municipal Elections 2009	
Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit në Kosovë për Zgjedhjet komunale 2009	Međunarodna posmatračka misija - Lokalni izbori na Kosovu 2009

Deklarata Kalimtare mbi Raundin e Parë të Zgjedhjeve Komunale dhe Certifikimin e Rezultateve

Përderisa raundi i parë i zgjedhjeve komunale të zhvilluara në Republikën e Kosovës ishte mbajtur në një atmosferë të qetë dhe të rregullt, shkeljet e vërejtura të procedurës dhe procesi i prolonguar i finalizimit të rezultateve shtron bazë për disa shqetësime.

Prishtinë, 9 dhjetor 2009.

Misioni ndërkombëtar për observimin e zgjedhjeve ENEMO ka përcjellur procesin zgjedhor në Kosovë që nga fillimi i tetorit dhe ka lëshuar deklaratën e saj të parë preliminare më 16 nëntor 2009 (në dispozicion në www.enemo.eu). Deklarata pasuese kalimtare pasqyron observimin e Ditës së Zgjedhjeve të 15 nëntorit dhe procesin e grumbullimit dhe publikimit të rezultateve përfundimtare. Misioni do të qëndroj në Kosovë për të observuar raundin e dytë të zgjedhjeve më 13 dhjetor. Për më shumë informata, ju lutem shikoni në fund të këtij dokumenti.

Komisioni Qendror Zgjedhor u përpoq të krijoj kushtet e domosdoshme për një zhvillim efikas dhe pozitiv të procesit zgjedhor. Kjo punë ishte kryer në një mënyrë transparente për ti tejkaluar mangësitë e vërejtura në ditën e zgjedhjeve dhe sfidat në procesin e numërimit dhe certifikimit të rezultateve të observuara, dhe misioni ENEMO dëshiron të shfrytëzon rastin për ti dhënë disa gjetje dhe rekomandime për përmirësim në raundin e dytë.

Dita e Zgjedhjeve

- Një udhëzim preciz mbi Dokumentet identifikuese të pranueshme është qenësore me qëllim të parandalimit të zhvleftësimit të votuesve. Raundi i dytë duhet të përfaqësojë një mundësi për udhëzime më precize të dhëna zyrtarëve zgjedhor përkitazi me çështjen se cilët ID janë të vlefshme dhe të pranueshme për një qytetarë të hedh votën;
- Parregullsitë e vërejtura dhe të thëna nga ENEMO referojnë në faktin se disa komisionarë brenda vendeve votuese kanë lejuar një numër veprimesh të cilat devijojnë nga standardet ndërkombëtare. Një numër i konsiderueshëm i vrojtuar i rasteve të votimit familjar nënkupton se fshehtësia e votës nuk ishte ruajtur në këtë drejtim. Andaj, për votimin me 13 dhjetor, anëtarët e komiteteve të vend-votimeve duhet të implementojnë procedurat votuese në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe udhëzimet e lëshuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor;
- Autoritetet funksion-bartëse duhet të shmangen nga përdorimi i burimeve administrative gjatë rrjedhës së fushatës.

Numërimi, publikimi dhe certifikimi i rezultateve

Komisioni Qendror Zgjedhor ka bërë përpjekje të theksuara për t'i zhvilluar zgjedhjet në linjë me standardet ndërkombëtare. Gabimet administrative dhe teknike të bëra në vendet e votimit (VV) dhe nivelin e komisioneve komunale të zgjedhjeve (KKZ) u bënë evidente gjatë përmbledhjes së gjatë dhe lodhshme të procesit të rezultateve në Qendrat Numëruese dhe të Rezultateve (QNR). Procesi pas Ditës së Zgjedhjeve ka zbuluar mangësitë:

- **Paketimi dhe Transferimi i Materialeve**

Procesi i transferimit të materialeve nga VV deri te KKZ a pastaj deri te QNR zgjati më shumë se që ishte pritur dhe nuk ishte në pajtueshmëri me orarin e planifikuar fillimisht.

Jo i gjithë stafi i vend-votimeve i ishte përmbajtur saktësisht procedurave të paketimit dhe materialet zgjedhore kërkuan korrigjime apo mungonin gjë që rezultoi në vonesa në numërim pasi që materialet e vend-votimeve duhej të vendoseshin në karantinë në pritje të hetimeve të mëtejme.

- **Publikimi i rezultateve**

Për të qenë në gjendje që të publikoj rezultatet preliminare KQZ vendosi që të përdor sistemin ku mesazhet SMS do të dërgohen nga secili vend-votim. Sistemi nuk funksionoi por KQZ arriti, megjithatë, që të publikojë rezultatet preliminare brenda dy ditësh, bazuar në numërimet e bëra në nivelin KKZ.

Këto rezultate preliminare të publikuara kanë, megjithatë, shumë mos-përputhshmëri për shkak të rezultateve munguese të vend-votimeve dhe gabimeve të shumta llogaritëse të cilat shkaktuan keq-interpretime dhe konfuzitet mes autoriteteve funksion-bartëse.

Rezultatet finale për zgjedhjet për Kryetarë Komunash ishin publikuar më 27 nëntor dhe ishin certifikuar më 4 dhjetor, që është vetëm një ditë para fillimit të periudhës së fushatës për raundin e dytë. Rezultatet përfundimtare për Asambletë Komunale ishin publikuar më 1 dhjetor.

- **Niveli i tolerancës për gabimet gjatë bashkë-renditjes**

Gabimet administrative dhe të numërimit detyruan KQZ për të ngritur nivelin e tolerancës për mos-përputhjet e ballafaquara në mes të numrit të nënshkrimeve në listat e votuesve dhe numrit të flet-votimeve të gjetura në pakot e votimit. Niveli tjetër ishte përcaktuar në +/- 9 në vend të +/- 3 siç ishte rregulluar me rregullat zgjedhore të KQZ.

Përkundër këtij niveli të lartë të tolerancës, KQZ zhvleftësoi rezultatet në 6 vend-votime ku niveli ishte tejkaluar. Asnjëherë nuk ka pasur diskutim mbi ndonjë përsëritje eventuale të votimit për votuesit e zhvleftësuar në këto vend-votime.

- **Shqetësimet në lidhje me daljen në zgjedhje**

Ndonëse rezultatet e certifikuar treguan se dalja e gjithmbarshme në raundin e parë në Kosovë ishte 44,7%, ka pasur vend-votime ku dalja ishte jashtëzakonisht e lartë, në një numër rastesh më e lartë se 90% e në disa raste madje 100%. Duke pasur parasysh mos-përputhjet e mëparshme të përcaktuara të listave të votuesve, dalja e sipër-përmendur mund të ngris disa shqetësime. Për më tepër, KQZ i zhvleftësoi 2 vend-votime me dalje më shumë se 100%.

- **Procesi i parashtresave dhe ankesave**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) është organi përgjegjës për zgjidhjen e çdo parashtrese dhe ankese përkritazi me zgjedhjet. KZAP ka pranuar 340 parashtresa deri më tani, nga të cilat 214 janë zgjidhur. Shumica e parashtresave të pranuar kanë rezultuar në vendime nga KZAP për gjobitjen e Partive Politike për shkelje të Kodit të Mirësjelljes gjatë periudhës së fushatës. Vendimi më i theksuar kishte të bëjë me zhvleftësimin e rezultateve nga 15 vend-votime si rezultat i veprimeve mashtruese të stafit të vend-votimit të ndërlidhur me manipulimin e listave të votuesve.

Është me rëndësi se këto veprime të stafit të vend-votimeve konsiderohen si vepra penale dhe si të tilla ndjeken nga institucionet përkatëse.

KZAP nuk ka ushtruar pushtetin e tij sipas Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, që të drejtoj KQZ-në që të përsërit votimin në këtë 15 vend-votime. Andaj, votuesit ishin privuar nga mundësia për të shprehur vullnetin e tyre për shkak të mos-mirësjelljes së stafit të vend-votimit.

Kjo deklaratë është gjithashtu në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe.

Megjithatë, versioni anglisht mbetet dokumenti i vetëm zyrtar.

Rrjeti Evropian i Organizatave Monitoruese të Zgjedhjeve (ENEMO) është një grup prej 22 organizatave udhëheqëse civile nga 17 shtete të Evropës Lindore dhe Qendrore dhe Azisë Qendrore. Organizatat anëtare të ENEMO kanë monitoruar më shumë se 140 zgjedhje nacionale dhe kanë trajnuar më shumë se 190,000 observues. ENEMO pretendon të mbështesë interesin e komunitetit ndërkombëtar për dhe promovimin e demokracisë në regjionet e angazhimit, për të vlerësuar proceset zgjedhore dhe ambientin politik dhe për të ofruar raporte të sakta dhe të

paanshme observuese. Misionet observuese ndërkombëtare ENEMO vlerësojnë proceset elektorale duke përdorur standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe pikë-synimet në legjislacionin dhe kushtetutën e shtetit të vlerësuar.

Pas ftesës së Presidentit të Republikës së Kosovës, PhD. Fatmir Sejdiu, për të observuar Zgjedhjet Komunale 2009, më 12 tetor 2009, Ekipi Kryesues ENEMO arriti dhe u përgatit për të sjellur 12 vëzhgues afat-gjatë në 6 ekipe që mbulonin tërë territorin e Kosovës, për të monitoruar ambientin para-zgjedhor përfshirë edhe fushatat politike dhe aktivitetet e administratës zgjedhore para 15 nëntorit. Në Ditën e Zgjedhjeve, më 15 nëntor, ENEMO solli 106 vëzhgues të zgjedhjeve të cilët vizituan 563 vend-votime në të gjitha komunat e Kosovës ku janë mbajtur zgjedhjet. Për këtë Mision Vëzhgues të posaçëm të Zgjedhjeve, vëzhguesit e ENEMO kanë ardhur nga 16 organizata anëtare të ENEMO dhe 8 shtete të ndryshme shtesë nga Evropa dhe Euro-Azia.

Raporti vëzhgues preliminar i ENEMO bazohet në observimet e gjetjeve të vëzhguesve afat-gjatë dhe afat-shkurtë me referencë në standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin nacional zgjedhor. Misioni thekson se kjo deklaratë kalimtare nuk është një vlerësim përfundimtar deri në fund të procesit zgjedhor i cili përfshin zgjedhjet e raundit të dytë, numërimin e votave, shpalljen e rezultateve dhe parashtresat eventuale që do të adresohen. Deklarata preliminare e Zgjedhjeve të 13 dhjetorit do të jepet të hënën, më 14 dhjetor dhe në janar do të publikohet raporti përfundimtar.